

# **Prezantuar nga: IP-GITEC dhe GTZ**

Janar 2003

---

## **RREGULLORE BASHKIAKE PËR ADMINISTRIMIN E MBETURINAVE**

**Përgatitur nga:**

Alba Dakoli Wilson, FLAG, dhe 'Grupi i Punës së Mbetjeve'  
me specialistet e Bashkive:

Filloreta Buzo (Vesho), Pogradec

Leonard Gjançi, Korçë

Ibrahim Gjevori dhe Agron Mino, Elbasan

asistuar me ekspertizë gjermane nga Claudia Pfirman.

në kuadër të “Programit mbi Modernizimin e Shërbimeve  
Publike në Qytetet Partnere”, financuar nga Qeveria Gjermane  
dhe implementuar nga GTZ dhe IP.

Në mbështetje të: Ligjit Nr.8934, datë 05.09.2002 ‘PËR MBROJTJEN E MJEDISIT’, Neni 59 “Konrolli për gjendjen e mjedisit qendron në mbikqyrjen e elementëve natyrore e njerëzore të mjedisit, në vëzhgimin dhe regjistrimin e ndryshimeve të tyre dhe në mbikqyrjen e burimeve dhe të shkaqeve të këtyre ndryshimeve. Kontrolli ushtrohet në mënyrë të përhershme e të vazhdueshme, të përsëritshme, në përputhje me parametrat, burimet dhe shkaqet e ndotjes ose dëmtimit të mjedisit”.

Në mbështetje të: Ligjit Nr.8934, datë 05.09.2002 ‘PËR MBROJTJEN E MJEDISIT’, Neni 73, gërma dh-f: “Organet e qeverisjes vendore përfaqësojnë strukturën më të rëndësishme shtetërore për administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit që kanë në juridiksion, duke zbatuar përgjegjësitë, të drejtat e detyrat që u jep ligji Nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Në mbrojtje të mjedisit ato kanë për detyrë: **dh.** Të përcaktojnë vendet e grumbullimit e të përpunimit të mbeturinave prodhuese dhe jetsore, në përputhje me kriteret mjedisore dhe planet e zhvillimit; **e.** të organizojnë depozitimin e mbeturinave dhe të lëndëve të rrezikshme dhe ruajtjen e zonave të gjelbra në qendrat qytëse dhe rreth tyre; **w.** të administrojnë mbeturinat qytetëse, impiantet e trajtimit të ujrave të ndotura dhe të mbeturinave të ngurta; **f.** të disiplinojnë transportin dhe ndërtimet në mjediset qytetëse.

Në mbështetje të: Ligjit Nr.8094, datë 21.3.1996, ‘PËR LARGIMIN PUBLIK TË MBETURINAVE’, Neni 9 “Metodat dhe teknologjitë që përdoren ose do të përdoren për largimin publik të mbeturinave, caktohen nga bashkitë dhe komunat, në bashkëpunim me organet kompetente, sipas rregullores për shërbimin e pastrimit publik”.

Në mbështetje të: Ligjit Nr.8094, datë 21.3.1996, ‘PËR LARGIMIN PUBLIK TË MBETURINAVE’, Neni 19 “Largimi publik i mbeturinave (pastrimi) është mbledhja me kontenier dhe transportimi i tyre në vendet e caktuara nga bashkia e qytetit ose komuna. Mbledhja dhe transportimi i mbeturinave bëhet në përputhje me rregullat teknike të higjienës dhe të depozitimit të tyre, të përcaktuara në rregulloren e pastrimit të qyteteve”.

Në mbështetje të: Ligjit Nr.8094, datë 21.3.1996, ‘PËR LARGIMIN PUBLIK TË MBETURINAVE’, Neni 20 “Largimin publik të mbeturinave e organizojnë organet e pushtetit lokal, në zbatim të procedurave të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave”.

Në mbështetje të: Ligjit Nr.8094, datë 21.3.1996, ‘PËR LARGIMIN PUBLIK TË MBETURINAVE’, Neni 25 “Vendgrumbullimi i mbeturinave publike, për bashkitë e qytetit dhe komunat, është gjithnjë jashtë perimetrit të vijës kufizuese të tyre”.

Në mbështetje të: Ligjit Nr.8094, datë 21.3.1996, ‘PËR LARGIMIN PUBLIK TË MBETURINAVE’, Neni 31 “Bashkitë dhe komunat caktojnë tarifën për largimin publik të mbeturinave. Tarifën e pastrimit caktohen duke pasur parasysh teknikën dhe teknologjinë e përdorur, koston, numrin e kontenierëve dhe kushte të tjera”.

Në mbështetje të: Ligjit Nr.8094, datë 21.3.1996, ‘PËR LARGIMIN PUBLIK TË MBETURINAVE’, Neni 37 “Shkelja e dispozitave të këtij ligji, parashikuar në nenet 7, 11, 14, 15, 23, 24 dhe 27, keqpërdorimi, ndërrimi i destinacionit të kazanëve, koshave, stacioneve të betonuara të plehrave, hedhja e parregullt e plehrave dhe atyre voluminoze, hedhja e mbeturinave të rrezikshme e të dëmshme, parkimi i mjeteve para ose pranë pikave të mësipërme, mospastrimi i hapësirave publike dhe terreneve private, hedhja në terriore dhe

sipërfaqe publike e mbeturinave të përcaktuara në nenin 5, mospastrimi i vendeve përreth lokaleve ose pikave ambulante të shitjes, dënohen me gjobë nga 1000 lekë deri në 5000 lekë. Gjobat vendosen nga inspektorët sanitarë të caktuar nga bashkia ose komuna”.

Në mbështetje të: Ligjit Nr.8652 datë 31.7.2000, Neni 7 pika 2 “Organet e njësisve të qeverisjes vendore ushtrojnë kompetencat e tyre nëpërmjet vendimeve, urdhërave dhe urdhërave”.

Në mbështetje të: Ligjit Nr.8652 datë 31.7.2000, Neni 8, pika I, paragrafi b) “bazuar në Kushtetutë, në ligje dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave, nxjerrin urdhëresa, vendime dhe urdhëra që janë të detyrueshme për të gjitha subjektet e përfshira në akt, në juridiksionin e tyre”.

Në mbështetje të: Ligjit Nr.8652 datë 31.7.2000, Neni 8, pika III, paragrafi b) “vendosin taksa e tarifa për shërbimet si dhe nivelin e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe interesat e bashkisë”.

Në mbështetje të: Ligjit Nr.8652 datë 31.7.2000, Neni 10 “Komunat dhe bashkitë ushtrojnë këto funksione të veta: f) grumbullimi, largimi dhe përpunimi i mbeturinave”.

Në mbështetje të: Ligjit Nr.8652 datë 31.7.2000, Neni 72, pika 4 “Duke filluar nga Janari 2001, komunat dhe bashkitë janë tërësisht përgjegjëse për kryerjen e funksioneve të veta të mëposhtme e) grumbullimin, largimin dhe përpunimin e mbeturinave”.

URDHËROHET NGA KËSHILLI I BASHKISË  
QË  
“ADMINISTRIMI I MBETURINAVE NË BASHKINË E

---

BËHET SIPAS RREGULLORES NË VIJIM”



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KËSHILLI BASHKIAK \_\_\_\_\_

Këshilli Bashkiak i \_\_\_\_\_, i mbledhur sot më datë \_\_\_\_\_ 2003, pasi shqyrtoi projekt rregulloren e paraqitur nga GTZ; duke vlerësuar se mbrojtja dhe mirëmbajtja e mjediseve urbane është detyrë e të gjithë qytetarëve dhe u shërben atyre; mbështetur në gërmën “k” të nenit 32 të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjeve vendore”; në gërmën “e” të nenit 73 të ligjit nr.8934, datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”; në ligjin nr.8094, datë 23.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”: në ligjin nr. 7697, datë 07.04.1993 “Për kundërvajtjet administrative”;

### V E N D O S I:

**Të miratojë si më poshtë:**

## TALBELA E PËRMBAJTJES

<b>KREU I</b> .....	7
<b>DISPOZITA TË PËRGJITHSHME</b> .....	7
1. QËLLIMI .....	7
2. OBJEKTI.....	7
3. PËRCAKTIMI I TERMAVE .....	7
4. PROCESI I ADMINISTRIMIT TË MBETURINAVE .....	8
5. FAZAT E PROCESIT TË ADMINISTRIMIT TË MBETURINAVE.....	9
6. KLASIFIKIMI I MBETURINAVE .....	9
7. MBETURINAT OBJEKT I RREGULLORES .....	10
<b>KREU II</b> .....	11
<b>VEÇIMI, SISTEMIMI DHE DORËZIMI I MBETURINAVE</b> .....	11
1. VEÇIMI DHE SISTEMIMI I MBETURINAVE .....	11
2. DORËZIMI I MBETURINAVE.....	11
3. KUFIZIMIET PËR DORËZIMIN E MBETURINAVE .....	12
<b>KREU III</b> .....	13
<b>PASTRIMI I RRUGËVE,SHESHEVE DHE TROTUAREVE</b> .....	13
1. TË PËRGJITHSHME .....	13
2. PASTRIMI I TERRITOREVE.....	13
3. PASTRIMI DHE LARJA E RRUGËVE .....	13
4. PASTRIMI I PUSHTAVE DHE DORËZIMI I MBETURINAVE TË PASTRIMIT.....	14
<b>KREU IV</b> .....	15
<b>GRUMBULLIMI, LARGIMI E TRANSPORTIMI I MBETURINAVE</b> .....	15
1. GRUMBULLIMI I MBETURINAVE .....	15
2. LARGIMI PUBLIK I MBETURINAVE .....	16
3. TRANSPORTI I MBETURINAVE.....	16
<b>KREU V</b> .....	17
<b>TRAJTIMI DHE VEND-DEPOZITIMI MBETURINAVE URBANE</b> .....	17
1. PËRSHKRIMI I TERMAVE.....	17
2. KËRKESA TË PËRGJITHSHME.....	17
3. DOKUMENTACIONI PËR VEND-DEPOZITIMIN.....	18
A. <i>Kushtet e Përgjithshme për Sipërfaqen</i> .....	18
i. Studim mbi karakteristikat rajonale.....	18
ii. Studim mbi karakteristikat lokale.....	18
iii. Raporti hidro-gjeologjik i sipërfaqes .....	19
iv. Kufizimet e vend ndodhjes së vend-depozitimit.....	19
B. <i>Kërkesat mbi Projektin</i> .....	19
i. Plani i strukturës së vend depozitimit .....	20
ii. Plani inxhinierik .....	20
iii. Plani i sigurisë së cilësisë së ndërtimit .....	21
iv. Plani i veprimit .....	21
v. Plani përmbyllës dhe post-përmbyllës .....	22
vi. Plani i monitorimit të cilësisë së ujit.....	22

4. KUFIZIMET PËR VENDNDODHJEN E VEND-DEPOZITIMIT .....	24
5. KËRKESAT PËR NDËRTIMIN E VEND-DEPOZITIMIT .....	25
6. KËRKESAT PËR RUAJTJEN E ELEMENTEVE QË DALIN NGA RRJEDHJA.....	26
<b>KREU VI.....</b>	<b>28</b>
<b>KOMPOSTIMI I MBETURINAVE URBANE ORGANIKE .....</b>	<b>28</b>
1. KUSHTE PËR KOMPOSTIMIN.....	28
2. KUFIZIME PËR STRUKTURAT E KOMPOSTIMIT .....	29
3. KËRKESAT OPERACIONALE PËR STRUKTURAT E KOMPOSTIMIT .....	29
4. PLANI I MONITORIMIT TË CILËSISË SË UJIT.....	30
5. SHPËRNDARJA E PRODUKTEVE TË KOMPOSTIMIT .....	31
6. KUFIZIMET E VEND-NDODHJES PËR STRUKTURAT E KOMPOSTIMIT.....	31
7. KËRKESAT PËR NDËRTIMIN E STRUKTURËS SË KOMPOSTIMIT .....	32
8. KËRKESAT PËR RUAJTJEN E ELEMENTEVE QË DALIN NGA KULLIMI.....	33
<b>KREU VII .....</b>	<b>35</b>
<b>TARIFAT.....</b>	<b>35</b>
1. VJELJA E TARIFËS.....	35
2. OBJEKTI I TARIFËS .....	35
3. TAKSAPAGUESIT .....	35
<b>KREU VIII.....</b>	<b>36</b>
<b>SANKSIONET.....</b>	<b>36</b>
<b>KREU IX.....</b>	<b>37</b>
<b>MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN .....</b>	<b>37</b>
1. DETYRIMI PËR INFORMIM .....	37
2. PROCEDURAT E ANKIMIMIT DHE EKZEKUTIMI.....	37
A. Marrja e Ankesës dhe Shqyrtimi.....	37
B. Zgjidhja e Ankesës.....	37
3. ZBATIMI I RREGULLORES.....	38
<b>HYRJA NË FUQI .....</b>	<b>38</b>

# RREGULLORE MBI ADMINISTRIMIN E MBETURINAVE DHE PASTRIMIN NË BASHKINË E \_\_\_\_\_

## KREU I

### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

---

#### Neni 1

##### 1. Qëllimi

- 1) Duke detajuar te drejtat dhe detyrat e të gjithë palëve që marrin pjesë në procesin e administrimit të mbeturinave të ngurta urbane, rregullorja synon të lehtësojë zbatimin e kërkesave të legjislacionit të kësaj fushe dhe të mundësojë një kontroll efektiv e të vazhdueshëm në zbatimin e tyre.

#### Neni 2

##### 2. Objekti

- 2) Kjo rregullore përcakton mënyrën e administrimit mjedisor të mbeturinave urbane në territorin e Bashkisë së \_\_\_\_\_ duke saktësuar rregullat, teknikat e metodat e trajtimit të tyre në çdo fazë të këtij administrimi, me qëllim mbrojtjen nga ndotja me mbeturina të mjedisit urban dhe mbajtjen e një mjedisi të shëndetshëm për banorët e qytetit të \_\_\_\_\_.

#### Neni 3

##### 3. Përcaktimi i termave

- 3) Në kuptimin e kësaj rregulloreje:
- 4) "**Dorëzimi**" quhet nxjerrja dhe hedhja e mbeturinave nga prodhuesit e tyre në vendet e mbledhjes së mbeturinave.
- 5) "**Grumbullimi i mbeturinave**" quhet procesi i pranimit të mbeturinave në vende të caktuara.
- 6) "**Konsumatori**" quhet një njësi komerciale, industriale a institucionale, ose një person që mund të përdorë shërbimet e kontenierëve dhe ku shërbimi i mbledhjes së mbeturinave sigurohet nga kontraktuesi.
- 7) "**Largimi publik i mbeturinave**" quhet procesi i dorëzimit, mbledhjes, transportimit dhe grumbullimit të mbeturinave.
- 8) "**Mbeturina të papranueshme**", janë mbeturinat e rrezikshme a të vëllimshme, të cilat administrohen me ligje të veçanta.
- 9) "**Mbeturina**" janë lëndët ose objektet që dalin nga veprimtaria njerëzore ose ciklet natyrore të destinuar për braktisje.
- 10) "**Mbeturina të rrezikshme**" janë mbeturinat toksike gërryese, ngacmuese, shpërthyes, të përfllakshme, kancerogjene, infektive dhe radioaktive, që kanë

vetinë të prishin gjendjen natyrore të ujit, tokës dhe ajrit, me pasoja në shëndetin e njeriut dhe në ekosistemet natyrore.

- 11) **"Objekt i vëllimshëm"** quhen objektet e mëdha të mbeturinave të ngurta, si pajisje, mobilie, pjesë autoveturash, penobetone, metale dhe mbeturina të tjera të vëllimshme, përmasat e të cilave pengojnë përdorimin e metodave të zakonshme të mbledhjes, transferimit ose hedhjes së tyre.
- 12) **"Vend-depozitimi"** i mbeturinave është sipërfaqe toke e caktuar nga organet e qeverisjes vendore për përpunimet dhe manipulimet që do të realizohen.
- 13) **"Zonë e kontratës"** quhet zona brenda kufijve të vijës së verdhë, ku kontraktuesi do të sigurojë shërbimin e administrimit të mbeturinave ndaj konsumatorëve ekzistues, si dhe atyre që mund të shtohen gjatë kohështrirjes së kontratës brenda së njëjtës zonë. Kufijtë e zonës së kontratës përcaktohen nga bashkia ose komuna.
- 14) **"Zonë e lagies"** quhet shërbimi i lagies së rrugëve, pa trotualet e rrugëve.

#### **Neni 4**

##### **4. Procesi i administrimit të mbeturinave**

- 15) Procesi i administrimit të mbeturinave synon që:
  - Të rezultojnë sa më pak mbeturina nga veprimtaritë prodhuese;
  - Në mbeturinat e krijuara, ta zënë vendin kryesor mbeturinat e degradueshme, të riciklueshme e të përpunueshme;
  - Të përdoren vetëm teknikat dhe metodat më të mira të mundshme të bazuara në kritere mjedisore për ndarjen, grumbullimin, transportimin, ruajtjen, përpunimin dhe asgjësimin e mbeturinave;
  - Të realizohet një cikël sa më i shkurtër për administrimin e mbeturinave me qëllim që të zvogëlohet koha e ekspozimit të tyre në mjedis;
  - Mbeturinat t'i nënshtrohen sa më shumë riciklimit dhe përpunimit;
  - Të grumbullohen dhe të trajtohen të ndara mbeturinat në të gjitha fazat e administrimit të tyre dhe të mos përzihen me mbeturinat e rrezikshme;
  - Të mos pengohet përdorimi i mëtejshëm i mbeturinave nga trajtimi i tyre në një fazë të mëparshme;
  - Të pakësohet sa më shumë levizja dhe transporti i mbeturinave dhe asgjësimi i tyre të kryhet në impiantin më të afërt;
  - Të parandalohet ndotja nga mbeturinat dhe t'i kufizohet ndikimi kur ajo ndodh;
  - Të ruhen sidomos burimet natyrore nga ndikimet e mbeturinave;
  - Të dëmshpërblehet dhe të rehabilitohet nga personat fizike dhe juridikë ndotja dhe dëmtimi që shkaktohet prej tyre nga keqadministrimi i mbeturinave;
  - Të kryhet groposje e sigurtë për hedhurinat që rezultojnë pas përpunimit të mbeturinave;
  - Të mënjanohet çdo dëm a rrezik për shëndetin, mirëqenien dhe sigurinë e jetës së personit;



- Të garantohen kërkesat higjieniko-shëndetësore dhe të mënjanohet çdo rrezik për ndotjen e mjediseve urbane;
  - Të ruhet fauna dhe flora, mjedisi e peisazhi nga degradimi;
- 16) Të gjitha llojet e mbeturinave, sipas përcaktimit të bërë në këtë rregullore, pas dorëzimit të tyre nga krijuesit janë pronë shtetërore.

## Neni 5

### 5. Fazat e procesit të administrimit të mbeturinave

- 17) Procesi i administrimit të mbeturinave përfshin krijimin, grumbullimin, ruajtjen dhe sistemimin e tyre nga krijuesi, dorëzimin sistematik në kazana, transportimin nga kazanët për në vend-depozitim, ndarjen, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin përfundimtar në vend-depozitim.

## Neni 6

### 6. Klasifikimi i mbeturinave

- 18) Në funksion të kësaj rregulloreje mbeturinat ndahen në kategoritë e mëposhtme:
- I. Mbeturina Industriale
  - II. Mbeturina Bujqësore
  - III. Mbeturina Spitalore
  - IV. Mbeturina Urbane
- 19) I – ‘**Mbeturina Industriale**’: quhen mbeturinat e ngurta të krijuara si rezultat i prodhimit apo proceseve industriale, dhe që nuk bën pjesë në Mbeturinat e Rrezikshme.
- 20) II – ‘**Mbeturina Bujqësore**’: quhen mbeturinat e krijuara nga kultivimi i bimëve dhe mbarështimi/mbajtja e kafshëve.
- 21) III – ‘**Mbeturina Spitalore**’ quhen:
- “mbeturinat patologjike” antropogjene që dalin nga operationet e autopsitë;
  - “mbeturinat mikrobiologjike” që përfshijnë kulturat e mbjella me agjentë të ndryshëm mikrobiologjike. Këtu përfshihen edhe kulturat e laboratorëve mjekësore, patologjike, farmaceutike, kërkimore - shkencore, industriale dhe të bizneseve;
  - “mbeturinat e mprehta” që përfshijnë gjilpërat, shiringat, thikat e operationeve.
- 22) IV – ‘**Mbeturina Urbane**’: quhen mbeturinat e ngurta të cilat krijohen nga ekonomitë familjare duke përfshirë edhe objektet e vëllimshme, mbeturinat e bizneseve që administrohen së bashku me mbeturinat familjare, mbeturinat e oborreve private, tregjeve të lira, pastrimit të rrugëve dhe shesheve si dhe mbeturinat e ngurta të prodhuara nga përpunimi i ujërave të zeza apo pastrimi i formacioneve ujore sipërfaqësore (përrenj, lumenj, liqene).

## Neni 7

### 7. Mbeturinat objekt i rregullores

- 23) **Mbeturina Urbane**, të cilat janë objekt i kësaj rregulloreje përfshijnë dy kategori mbeturinash të ngurta:
- “mbeturina familjare” të krijuara nga ekonomitë shtëpiake duke përfshirë shtëpitë ku banojnë një apo disa familje, stacionet, zyrat, kopështet, lulishtet, oborret, vendet e argëtimit dhe zonat e piknikut;
  - “mbeturina të bizneseve” të krijuara nga veprimtaria e ndërmarrjeve private e shtetërore të karakterit artizanal, tregëtar apo të shërbimeve; mbeturina të cilat kanë karakteristika dhe cilësi që mundësojnë grumbullimin dhe trajtimin e tyre së bashku me mbeturinat familjare.
- 24) Në funksion të kësaj rregulloreje, Mbeturinat Urbane i ndajmë në dy kategori:
- 25) **Mbeturina Urbane të Riciklueshme** – të cilat përfshijnë mbeturina që mund të ripërdoren ose mund të përpunohen duke u vënë në përdorim si lëndë e parë. Në këtë kategori përfshihen:
- Mbeturinat metalike
  - Mbeturinat e lulishteve, kopeshteve.
  - Mbeturinat plastike
  - Letrat dhe kartonat
  - Shishet e qelqit (qelqurinat)
- 26) **Mbeturina Urbane të Pariciklueshme** – të cilat përmbledhin të gjitha mbeturinat urbane që nuk përfshihen në kategorinë e Mbeturinave Urbane të Riciklueshme.

## Neni 8

- 27) Mbeturinat që prodhohen nga ekonomitë familjare, por që nuk përfshihen në Mbeturinat Urbane, si për shembull: mbeturinat e rrezikshme, mbeturinat nga ndërtimi apo prishja e ndërtesave dhe objektet e vëllimshme, transportohen nga vetë prodhuesit e tyre në fushat përkatëse të depozitimit, që specifikohen nga bashkia përkatësisht për secilën prej mbeturinave.

## KREU II

### **VEÇIMI, SISTEMIMI DHE DORËZIMI I MBETURINAVE**

---

#### **Neni 9**

##### **1. Veçimi dhe sistemimi i mbeturinave**

- 28) Familjet si dhe subjektet publike a private që gjatë veprimtarisë së tyre krijojnë mbeturina, i veçojnë ato në grupe si:
- mbeturina ushqimore
  - amballazhe (plastike, qelq, karton)
  - mbeturina ndërtimore (llaç, tulla, beton, dhera)
  - objekte të vëllimshme ( karrige, tavolina, kolltuqe, etj)
- 29) Secili grup trajtohet e ambalazhohet më vehte, në qeska a kosha të veçantë.
- 30) Mbeturinat e vëllimshme (automjete, makineri, pajisje), çohen nga pronaret në vendin e posaçëm për depozitimin dhe përpunimin e tyre. Braktisja e tyre jashtë vendeve të përcaktuara, përbën shkelje dhe ndëshkohet si e tillë.

#### **Neni 10**

- 31) Të gjithë subjektet që në përputhje me natyrën e veprimtarisë së tyre krijojnë lloje të ndryshme mbeturinash, janë të detyruar të kenë më shumë se një kosh për grumbullimin e ndarë e të veçuar të tyre.
- 32) Koshat janë me ngjyra të ndryshme ose me mbishkrime të dukshme që orientojnë hedhjen e veçuar të mbeturinave. Koshat vendosen në vende të dukshme dhe lehtësisht të përdorshme.
- 33) Spitalet, ambulancat, qendrat shëndetësore, laboratorët farmacitë, klinikat stomatologjike, shtetërore a private, detyrohen të përdorin sistemin e disa koshave për mbeturinat, njëri prej të cilëve është për mbeturinat e rrezikshme spitalore që i nënshtrohen një trajtimi të veçantë.
- 34) Çerdhet, kopshtet dhe shkollat, publike e private, janë të detyruar të përdorin sistemin e disa koshave për të edukuar nxënësit me normat e rregullat bashkëkohore të trajtimit të ndarë të mbeturinave.

#### **Neni 11**

##### **2. Dorëzimi i mbeturinave**

- 35) Sistemimi dhe dorëzimi i mbeturinave nga familjaret dhe nga të gjithë subjektet e tjerë, bëhet vetëm në vendet e mbledhjes së mbeturinave që ka caktuar Bashkia. Dorëzimi i tyre jashtë këtij rregulli, është shkelje dhe ndëshkohet si e tillë.
- 36) Tregëtarët dhe persona të tjerë që ushtrojnë shërbime ambulante, duhet të jenë të pajisur me kosh të posaçëm për grumbullimin e mbeturinave që u krijohen gjatë tregëtimit e shërbimit që u ofrojnë qytetarëve.

## **Neni 12**

- 37) Gjithë subjektet që kanë dyqane, pika shërbimi, godina si hoteleri, etj, si dhe tregëtarët ambulant, detyrohen të mbajnë pastër ambientin për rreth në një rreze prej 5 m., përfshi edhe trotuarin para dyqanit. Ndalohet hedhja dhe depozitimi i mbeturinave të këtyre subjekteve në rrugë, në trotuare, në lulishte apo në mjedise të tjera publike.

## **Neni 13**

### **3. Kufizimet për dorëzimin e mbeturinave**

- 38) Dorëzimi i mbeturinave teknologjike, ndërtimore, mbeturinave të zanatit, mbeturinave të vajrave lubrifikante, si dhe mbeturina të tjera që nuk konsiderohen si mbeturina urbane nga ligji nr.8094, datë 23.03.1995 “Për largimin publik të mbeturinave” dhe nga kjo rregullore, do të bëhet në pikat e veçanta të caktuara nga Bashkia për këtë qëllim.
- 39) Dorëzimi i tyre në vendet e mbledhjes së mbeturinave të caktuara në qytet për mbeturinat urbane, është e ndaluar dhe ndëshkohet.

## **Neni 14**

- 40) Mbeturinat ndërtimore dorëzohen në vendet e caktuara nga Bashkia për këtë qëllim. Gjatë procesit të ndërtimit, riparimit apo prishjes, qytetarët, investitorët dhe subjektet ndërtues, marrin masa për largimin e vazhdueshëm të mbeturinave ndërtimore.
- 41) Hedhja e mbeturinave ndërtimore në rrugë, në trotuare, në çdo mjedis publik, si dhe në pikat që ka caktuar Bashkia për mbeturinat urbane, është e ndaluar dhe përbën shkelje që ndëshkohet si e tillë.

## **Neni 15**

- 42) Ndalohet dprëzimi i mbeturinave në vendet e zbuluara të hapsirave private, në trojet e sheshet, prona të rikthyera, të rrethuara ose jo, në të cilat nuk ka filluar ndonjë veprimtari ndërtimore apo e çdo natyre tjetër. Pronarët e tyre janë të detyruar të kujdesen për mbajtjen pastër të tyre dhe të mos lejojnë kthimin e tyre në vende të depozitimit të mbeturinave.

## **Neni 16**

- 43) Kalimtarët, mbeturinat e çastit si amballazhe të ndryshme, i dorëzojnë vetëm në koshat e vendosur në qytet ose që ndodhen para dyqaneve. Ndalohet hedhja e tyre në rrugë, në trotuare apo në ambiente të tjera publike.

## **Neni 17**

- 44) Mbeturinat që dalin nga krasitja e pemëve, e hardhive, nga punimet në oborre, në lulishte e parqe, para se të çohen në vendet e mbledhjes së këtyre mbeturinave, priten në pjesë të vogla e palosen për të mos bllokuar kazanët dhe vështirësuar transportin.

## KREU III

### **PASTRIMI I RRUGËVE, SHESHEVE DHE TROTUAREVE**

---

#### **Neni 18**

##### **1. Të përgjithshme**

- 45) Autoritetet e Bashkisë, në bashkëpunim me strukturat përkatëse rajonale si përfaqësuesit e inspektoriatit sanitar shtetëror të rrethit, përfaqësuesit e inspektoriatit të mbrojtjes së mjedisit dhe ata të ndërmarrjes/sipërmarrjes së pastrimit, përcaktojnë dhe publikojnë grafikun e pastrimit të rrugëve, shesheve dhe trotuareve.
- 46) Pastrimi i rrugëve, shesheve dhe trotuareve bëhet përgjithësisht një herë në 24 orë, herët në mëngjes ose në orët e mbrëmjes, kur është ulur ndjeshëm aktiviteti qytetar. Gjatë ditës pastërtia sigurohet duke grumbulluar dhe larguar nga sheshet, rrugët e trotuaret, hedhurinat e ngurta të kalimtarëve si dhe ndotjet e tjera.

#### **Neni 19**

##### **2. Pastrimi i territoreve**

- 47) Hapësirat dhe territoret private pastrohen nga vetë pronarët e tyre.
- 48) Hapësirat e zbuluara publike që nuk janë të përfshira në skemën e pastrimit të qytetit pastrohen nga institucionet, apo banorët që janë përdorues të kësaj hapësire.
- 49) Gjithë personat fizikë dhe juridikë që kryejnë veprimtari stacionare ose ambulatore dhe ata që kryejnë veprimtari transporti, detyrohen të mbajnë pastër territorin përreth lokalit apo vendit të punës në gjerësi 5m.
- 50) Hapësirat e zbuluara publike që përfshihen në skemën e pastrimit pastrohen nga Bashkia.
- 51) Sheshet e tregëtimit pastrohen çdo ditë pas përfundimit të aktiviteteve.

#### **Neni 20**

##### **3. Pastrimi dhe larja e rrugëve**

- 52) Pastrimi dhe larja e rrugëve realizohet nga Bashkia, ose nga një palë e tretë e ngarkuar prej saj apo e kontraktuar për të kryer këtë shërbim. Në kontratë specifikohen të gjitha kushtet dhe kërkesat që ka Bashkia për pastrimin, kontrolli për zbatimin e tyre, si dhe sanksionet për shkelje të kushteve e kërkesave të kontratës.
- 53) Pastrimit i nënshtrohen të gjithë rrugët e asfaltuara, rrugët me kalldrëm, sheshet si dhe trotuaret e qytetit dhe të qendrës së banuar.

#### **Neni 21**

- 54) Rrugët dhe sheshet lagen pas pastrimit. Gjatë periudhës së nxehtë (prill-tetor) bëhet lagia e tyre çdo ditë. Numri i lagieve përcaktohet simbas sezonit dhe kushteve konkrete. Për larjen përdoret uji me ngarkesë bakteriale jo më shumë se 200 E koli për 100ml ujë. Në këto raste mund të përdoret edhe uji i detit dhe liqeneve.

- 55) Bashkia përcakton rrugët dhe sheshet që duhet të lahen. Për larjen e rrugëve përdoren automjete të posaçme.

#### **Neni 22**

- 56) Mbeturinat që dalin nga pastrimi i rrugëve, trotuareve dhe shesheve hidhen në pikat më të afërta të grumbullimit të mbeturinave.
- 57) Ndalohet kategorikisht hedhja e mbeturinave që dalin nga pastrimi i rrugëve, trotuareve dhe shesheve në pusetat e elektrikut, në pusetat e telefonisë, në pusetat e ujësjellësit, në pusetat e ujrave të zeza, në pusetat e hidranteve, në zgarat e pusetave të ujrave atmosferike, në shtretërit e ujrave rrjedhëse, në basenet ujore natyrale apo artificiale.

#### **Neni 23**

#### **4. Pastrimi i pusetave dhe dorëzimi i mbeturinave të pastrimit**

- 58) Çbllokimi dhe pastrimi i pusetave të rrugëve, bëhet vetëm nga punonjësit e subjektit të ngarkuar me administrimin e tyre.
- 59) Përpara sezonit të shirave kryhet pastrimi i të gjithë pusetave të ujrave atmosferike, për të siguruar në vazhdimësi transportimin e tyre. Mbas çdo pastrimi, hiqen menjëherë mbeturinat që dalin nga pastrimi dhe kryhet dezinfektimi përreth pusetës me lëndë dezinfektuese ose pluhur gëlqere me 5% përmbajtje klori.
- 60) Mbeturinat e nxjerra nga pastrimi i pusetave largohen menjëherë nga subjekti përgjegjës dhe depozitohen në vendet e përcaktuara nga Bashkia.

#### **Neni 24**

- 61) Ndalohet hedhja dhe derdhja në trotuar, rrugë e sheshe të qendrave të banuara e mbeturinave dhe ujrave që dalin nga larja e lokaleve të shërbimit publik.

## KREU IV

### **GRUMBULLIMI, LARGIMI E TRANSPORTIMI I MBETURINAVE**

#### **Neni 25**

##### **1. Grumbullimi i mbeturinave**

- 62) Grumbullimi i mbeturinave bëhet në vendet e mbledhjes së mbeturinave (VMM). VMM-të janë sipërfaqe të vogla që shërbejnë për dorëzimin e mbeturinave nga prodhuesit e tyre. VMM-të duhet të jenë të betonuara ose të asfaltuara.
- 63) VMM-të ku vendosen e konteinerët, kazanët apo stacionet e betonuara për grumbullimin e mbeturinave, caktohen nga Bashkia.
- 64) Këshilli Bashkiak, miraton dhe publikon skemën konkrete të vend-ndodhjes së VMM-ve dhe strukturën e përmasat e secilës. Ndryshimi i vendndodhjes së VMM-ve, pa miratim të bashkisë përbën shkelje dhe ndëshkohet si e tillë.

#### **Neni 26**

- 65) Grumbullimi i mbeturinave urbane bëhet në kontenierë, dhe, në raste të veçanta, edhe në sheshe të betonuara për këtë qëllim.
- 66) Konteinerët kanë sipërfaqe të lëmuara dhe janë lehtësisht të pastrueshëm. Materiali i tyre është i qëndrueshëm dhe i papërshkueshëm nga uji.
- 67) Konteinerët lahen dhe dezinfektohen sipas grafikut të miratuar nga Bashkia. Konteinerët mbahen gjithmonë në kushte optimale pune nga subjekti që është angazhuar me administrimin e mbeturinave.
- 68) Menjëherë mbas largimit të mbeturinave territori përreth sheshit të konteinerëve pastrohet në një sipërfaqe 6-10 m<sup>2</sup>. Kjo sipërfaqe dezinfektohet me gëlqere të kloruar (deri 5% klor aktiv) ose lëndë dezinfektuese.

#### **Neni 27**

- 69) Grumbullimi i mbeturinave që krijohen nga biznesi (i vogël, i mesëm, i madh), por që nuk përfshihen në kategorinë “mbeturinat të bizneseve” (si p.sh tallash, xham ,etj.), bëhet me kontenierë privatë të vendosur brenda sipërfaqes ku kryhet aktiviteti. Konteinerët private duhet të kenë të njëjtët parametra si edhe ata publikë.
- 70) Të gjithë shitësat e tregut të prodhimeve bujqësore e blegtorale, mbeturinat që krijojnë gjatë tregëtimit të produkteve vetjake, i grumbullojnë dhe i hedhin në pikat e përcaktuara nga Bashkia. Largimi nga tregu pa bërë këtë sistemim të mbeturinave është shkelje që ndëshkohet me moslejimin për të tregëtuar përsëri në treg.

#### **Neni 28**

- 71) Djegia e mbeturinave në kazana, rreth tyre dhe në çdo ambient tjetër, është kategorikisht e ndaluar dhe ndëshkohet si shkelje e rëndë sepse gazrat e tymrat e djegies rrezikojnë shëndetin e njeriut.
- 72) Ndalohet kullotja e kafshëve barngrënëse në mbeturinat e kazanëve e në pikat e grumbullimit të tyre, si dhe marrja prej mbeturinave e ushqimeve për kafshët si mbeturina buke, etj.

- 73) Ndalohet rëmimi, përzierja, derdhja e përhapja e mbeturinave të depozituata në kazana e në pikat e grumbullimit.

### **Neni 29**

#### **2. Largimi publik i mbeturinave**

- 74) Bashkia është përgjegjëse për detyrën e largimit të mbeturinave në zonën nën juridiksionin e saj.

### **Neni 30**

- 75) Të gjithë qytetarët, familjarët, biznesmenët e vegjël dhe të mëdhenj, gëzojnë të drejtën e përdorimit të rrjetit të objekteve publike të *largimit* të mbeturinave.
- 76) Bisnesi i vogël, i mesëm dhe i madh, nuk lejohet të përdorë kontenierët publikë për mbeturinat që nuk përfshihen në përkufizimin “mbeturinat urbane”.

### **Neni 31**

#### **3. Transporti i mbeturinave**

- 77) Transporti i mbeturinave për në vendet e depozitimit bëhet nga Bashkia ose nga një palë e ngarkuar prej saj.
- 78) Transporti organizohet e funksionon në orët e mbrëmjes apo herët në mëngjes. Transportimi i mbeturinave në orët e pikut të aktiviteteve qytetare, është i ndaluar dhe ndëshkohet si shkelje e kërkesave të kësaj rregulloreje.

### **Neni 32**

- 79) Transportimi i mbeturinave nga pikat e grumbullimit për në vendet e depozitimit e të përpunimit të tyre, bëhet me kamionë të posaçëm dhe të mbuluar, ngarkesa e të cilëve nuk rrezikon derdhjen apo rishpërndarjen e mbeturinave.
- 80) Kamionët që transportojnë lëndë dhe materiale ndërtimi ose që çojnë mbeturinat ndërtimore në vendet e depozitimit të tyre, marrin masa që gjatë lëvizjes të mos ketë derdhje apo rrjedhje të materialeve që transportojnë.
- 81) Kamionët, autoveturat, etj, kur hynë në rrugët e qytetit nga kantierët e ndërtimit dhe nga rrugë dytësore të paasfaltuara, janë të detyruar të pastrojnë gomat nga balta, llaçet, betonet e çdo papastërti tjetër që ndot qytetin.



## KREU V

### **TRAJTIMI DHE VEND-DEPOZITIMI MBETURINAVE URBANE**

#### **Neni 33**

##### **1. Përshkrimi i termave**

- 82) “Struktura e vend-depozitimit” është e gjithë toka dhe ndërtesat si dhe gjithçka tjetër që lidhet me to, brenda përshkrimit ligjor të sipërfaqes.
- 83) “Formacioni ujëmbajtës” është një formacion gjeologjik, një grup formacionesh, ose një pjesë e formacionit që është në gjendje të furnizojë sasi të mjaftueshme uji të nëndheshëm nëpërmjet burimeve apo krojeve.
- 84) “Jetë aktive” nënkupton periudhën e aktivitetit, që nga pranimi për herë të parë i mbeturinave të ngurta, deri në përfundimin e aktiviteteve përmyllëse.
- 85) “Njësia e vend-depozitimit” është një sipërfaqe e veçantë (e dallueshme), ose një zonë e gërmuar tek e cila grumbullohen mbeturinat, dhe që nuk është një grumbull mbeturinash.
- 86) “Sistem i shtresave” është sistemi i kontrollit inxhinierik mjedisor, i cili mund të përmbajë filtrat, shtresat e kullimit, shtresat e ngjeshura të dheut, sistemet e tubacioneve, shtresat gjeo-membranore dhe struktura të tjera të lidhura me to.
- 87) “Sistemi shtresave bazale” është një sistem shtresash i instaluar në themelet e njësisë së vend – depozitimit për të kontrolluar rrjedhjen.
- 88) “Sistemi i mbulesës përfundimtare” është një sistem shtresash i instaluar mbi njësinë e vend – depozitimit për të minimizuar infiltrimin e reshjeve atmosferike dhe për të mbuluar mbeturinat.
- 89) “Rrjedhja” nënkupton lëngjet e prodhuara nga mbeturinat

#### **Neni 34**

##### **2. Kërkesa të përgjithshme**

- 90) Puna në vend – depozitim e mbeturinave bazohet në dokumentacionin e paraqitur nga pronari ose operatori në procesin e marrjes së lejes për të vënë në funksionim një vend-depozitim. Pronari/operatori i saj paraqet dokumentacionin e nevojshëm, ashtu siç jepet në mënyrë të detajuar nga Neni 35 i këtij Kreu të rregullores. Aplikimi për leje përfshin edhe procedurat për informimin e publikut.
- 91) Leja për të ndërtuar dhe për të përdorur një vend – depozitim për mbeturinat jepet nga një komision i përbërë nga përfaqësues të:
- Qeverisë vendore
  - Inspektoratit sanitar shtetëror të rrethit
  - Inspektoratit të mbrojtjes së mjedisit
  - Ndërmarrjes pastruese të zonës së banuar

➤ Urbanistikës së bashkisë

- 92) Rekomandohet që caktimi i vend-depozitimit të jetë kufitar, që t'iu shërbejë dy ose më shumë zonave urbane.

### **Neni 35**

#### **3. Dokumentacioni për vend-depozitimin**

- 93) Vend-depozitimet ndërtohen dhe vihen në përdorim vetëm pasi subjekti përkatës të jetë pajisur me leje mjedisore dhe me licensat e lëshuara nga organet e qeverisjes vendore.
- 94) Personat fizikë dhe juridikë, publik ose privatë, vendas apo të huaj, që kërkojnë të ndërtojnë dhe të përdorin një vend-depozitim, plotësojnë kërkesat që shtjellohen në vijim.
- 95) Për të marrë lejen për të ndërtuar ose për të përdorur një vend-depozitim mbeturinash nevojitet një aplikim i plotë mbi **Kushtet e Përgjithshme për Sipërfaqen (Neni 36)**, dhe për **Kërkesat e Projektit (Neni 41)**.

### **Neni 36**

#### *A. Kushtet e Përgjithshme për Sipërfaqen*

- 96) Sipërfaqja është pjesa e tokës e propozuar për vend-depozitimin e mbeturinave. Studimi i sipërfaqes jep karakteristikat e tokës, ku përfshihen analiza të ndryshme që lidhen me përshtatshmërinë e përdorimit të saj për një njësi vend-depozitimi. Informacioni i studimit duhet të japë saktësisht karakteristikat e sipërfaqes. Ai hartohet nga specialistë të mjedisit. Studimi për njësinë e vend-depozitimit duhet të përmbajë:
- i. Studim mbi karakteristikat rajonale;**
  - ii. Studim mbi karakteristikat lokale;**
  - iii. Raporti hidro-gjeologjik i sipërfaqes;**
  - iv. Kufizimet e vend ndodhjes së vend-depozitimit.**

### **Neni 37**

#### *i. Studim mbi karakteristikat rajonale*

- 97) Studimi për rajonin përfshin sipërfaqen e vend-depozitimit si dhe një perimetër prej 3 kilometrash nga kufiri i propozuar për vend-depozitimin. Studimi përmban një raport dhe një hartë rajonale që identifikon: topografinë e përgjithshme; vend ndodhjen e propozuar për ndërtimin e vend-depozitimit të mbeturinave; pusët nga të cilat bëhet i mundur furnizimi i popullatës me ujë, zonat e shërbimeve; ndarjet e banesave; rrugët e transportimit të mbeturinave; dhe aeroportet dhe rrugët që përdoren nga publiku.

### **Neni 38**

#### *ii. Studim mbi karakteristikat lokale*

- 98) Studimi i karakteristikave lokale përmbledh vend – depozitimin e mbeturinave dhe një perimetër prej 500 metrash të matura nga kufiri i propozuar i tij. Studimi përfshin një raport dhe një hartë lokale. Studimi identifikon këto pika: të gjithë pasurinë e propozuar për vend-depozitimin; përdorimin aktual të tokës dhe zonimin; vend ndodhjen e shtëpive private dhe të shkollave; të ndërtesave tregtare dhe industriale dhe burimeve të

tjera të mundshme të ndotjes; vend ndodhjen e puseve të ujit të pijshëm dhe dokumentacionin mbi puset dhe shkallën e prodhueshmërisë së tyre; zonat historike; studimin eskzistues topografik dhe karakteristikat e vend-depozitimit, ku përfshihen: mënyrat e drenazhimit dhe formacionet ujëmbajtëse; zonat e përmbytura gjatë 100-vjeçarit të fundit, përrrenjtë e përhershëm dhe të përkohshëm, lumenjtë dhe liqenet.

### **Neni 39**

#### *iii. Raporti hidro-gjeologjik i sipërfaqes*

99) Raporti hidro/gjeologjik i sipërfaqes është një analizë për të vlerësuar karakteristikat hidro-gjeologjike të sipërfaqes së propozuar për vend-depozitimin e mbeturinave, për të treguar se cilat zona janë më shumë të përshtatshme për njësitë e vend-depozitimit si dhe rrugët dhe shpejtësinë e rrjedhjes së ujit nëntokësor për në formacionin ujëmbledhës më pranë sipërfaqes së tokës. Raporti shtjellon marrëdhëniet e regjimit të rrjedhës së ujit tokësor me karakteristikat rajonale hidro gjeologjike. Gjithashtu, studimi përfshin dhe një informacion të përgjithshëm gjeologjik, i cili është i nevojshëm për të bërë përshtatjet me kufizimet përkatëse të vend ndodhjes, ashtu siç jepen në Nenin 48 të këtij Kreu. Raporti mbi sipërfaqen hidro-gjeologjike duhet të përmbajë, të paktën këto informacione:

- Një raport mbi gjeologjinë dhe hidro-gjeologjinë rajonale të bazuar mbi hulumtimet e literaturës së disponueshme mbi zonën;
- Pusët monitoruese që identifikohen me anë të numrave, vend ndodhjes, dhe thellësisë dhe që janë të mjaftueshme për të pasqyruar qartë kushtet e nën sipërfaqes dhe të regjimit të rrjedhjeve nëntokësore të formacionit ujëmbajtës më pranë sipërfaqes së tokës;
- Profile tërthore të shtresave tokësore që tregojnë njësite hidro gjeologjike dhe litologjike dhe ngritjet e nivelit të ujit;
- Informacion mbi nivelin e ujit; dimensionet horizontale dhe vertikale të rrjedhjes së ujërave nëntokësore ku përfshihen drejtimet dhe pjerrësitë e rrjedhjes.

### **Neni 40**

#### *iv. Kufizimet e vend ndodhjes së vend-depozitimit*

100) Një raport duhet përgatitur për të demonstruar pajtueshmërinë me kriteret e dhëna në Nenin 48 të këtij kapitulli.

### **Neni 41**

#### *B. Kërkesat mbi Projektin*

101) Projekti për të ndërtuar ose përdorur një vend-depozitimi, përfshin:

- I. **Planin e strukturës së vend-depozitimit (Neni 42);**
- II. **Planin inxhinierik (Neni 43);**
- III. **Planin e sigurisë së cilësisë së ndërtimit (Neni 44);**
- IV. **Plani i veprimtimit (Neni 45);**
- V. **Planin përmbyllës dhe post-përmbyllës (Neni 46);**
- VI. **Planin e monitorimit të cilësisë së ujit (Neni 47).**

## Neni 42

### *i. Plani i strukturës së vend-depozitimit*

- 102) Ky plan përfshin një seri skicash, dhe një raport i cili prezanton koncepte afat-gjata dhe të përgjithshme të cilat lidhen me ndërtimin, veprimin, dhe mbylljen e njësive të vend-depozitimit, duke përfshirë menaxhimin e rrjedhjes. Qëllimi i planeve ka shtrirje kohore të njëjtë me jetën aktive të vend-depozitimit. Ky plan përcakton llojin e mbeturinave të propozuara për t'u menaxhuar në vend-depozitim.
- 103) Plani i vend-ndodhjes përfshin skica mbi **Ndërtimin dhe Funksonimin e Vend-Depozitimit**.
- 104) Plani përmban informacionin e mëposhtëm:

**Llojin e mbeturinave.** Karakteristikat e tyre, dhe planet specifike të menaxhimit; të dhëna mbi sasinë mujore të mbeturinave; kërkesat për paisje që nevojiten për funksionimin e vend-depozitimit.

**Kapacitetin e vend-depozitimit.** Vend-depozitimi parashikohet për një kohë zgjatje nga 5 deri në 10 vjet. Kapaciteti i tij llogaritet në funksion të numrit të popullsisë që i shërben, peshës së mbeturinave urbane të grumbulluara për çdo banor në vit, densitetit të ngjeshjes së mbeturinave, volumit e shtresës mbuluese.

## Neni 43

### *ii. Plani inxhinierik*

- 105) Plani inxhinierik përgatitet në përputhje me fazat e zhvillimit dhe me kriteret e hartuara në planin e strukturës së vend-depozitimit (Neni 42). Ai përfshin skicimin e menaxhimit të rrjedhjes, një raport dhe një seri skicash të cilat përbëjnë dizejimin inxhinierik.

- (i) **Raporti inxhinierik** përfshin: (a) Një analizë të skicës së strukturës së vend-depozitimit, sistemin e mbulesës përfundimtare, sistemin e grumbullimit të rrjedhjes (b) Skicën e vend-depozitimit (c) Një përshkrim të materialeve dhe të praktikave të ndërtimit të cilat janë në përputhje me kërkesat e dhëna në Nenin 49 të këtij Kreu (kërkesat mbi ndërtimin e vend-depozitimit).
- (ii) **Skica inxhinierike** jep të ilustruara në mënyrë të qartë: (a) Kushtet ekzistuese: topografine, karakteristikat, zonat ekzistuese të depozitimit, rrugët, ndertesat; (b) Planet mbi gjurmimet apo mbushjet: limitet e propozuara për gjurmimet; mbushjet e sipërfaqes; vend-ndodhjen e puseve monitorues; (c) Sistemin e shtresave bazale: strukturën e shtresës bazale të sipërme; pjerrtësitë dhe detaje të tjera. (d) Sistemin e grumbullimit të rrjedhjes: ngritja që i duhet bërë nga tabani i vend-depozitimit; sistemi i tubacioneve; pastrimi i valvulave; tapat për ruajtjen nga ngritja e nivelit të rrjedhjes; e detaje të tjera. (e) Sistemin e grumbullimit të ujrave atmosferike: vend ndodhjen dhe detaje të tjera, (f) Sistemin e mbulesës përfundimtare: mbushjet në tabanin dhe pjesën e sipërme të vend-depozitimit, mbledhjen e gazit vend – depozitim, pengesat për infiltrim, tërheqjen e ujit sipërfaqësor, mbulesën vegjetative dhe mbrojtëse; (g) Planet kontrolluese të përkohshëm dhe të përhershëm për sedimentimin dhe erozionin.

## Neni 44

### *iii. Plani i sigurisë së cilësisë së ndërtimit*

- 106) Ky plan përshkruan testimet dhe vëzhgimet të cilat përdoren përpara, gjatë dhe pas përfundimit të ndërtimit për të siguruar që materialet e ndërtimit përkojnë me specifikat e projektit të ndërtesës dhe me kërkesat e liçensimit, të dhëna në Nenin 49 të këtij Kreu (Kërkesat e ndërtimit e vend-depozitimit). Ky plan përshkruan gjithashtu procedurat për të siguruar që integriteti i vend-depozitimit do të mirëmbahet përpara fillimit të hedhjes së mbeturinave atje.

## Neni 45

### *iv. Plani i veprimit*

- 107) Pronari ose operatori i një vend-depozitimi përgatit një plan veprimi për secilën fazë të zhvillimit të strukturës së vend-depozitimit. Plani përfshin skica dhe një raport.
- 108) **Skicat e funksionimit dhe raporti.** Skicat përgatiten për secilën fazë të zhvillimit të vend-depozitimit dhe janë në përputhje me planin inxhinierik. Skicat e funksionimit përmbledhin këto pika: kushtet aktuale, duke përfshirë këtu zonat ekzistuese të depozitimit, mënyrën e funksionimit, vendosjen fillestare të mbeturinave, veprimet e përditshme, konturin fillestar dhe konturet përfundimtare; kontrollat mbi rrjedhjen dhe mbi ujrat nga reshjet, zonat amortizuese. Raporti duhet të japë një përshkrim të skicave dhe përmban një përshkrim të funksionimit të strukturës që është në përputhje me këto pika:
- (a) **Pranimi i mbeturinave dhe kërkesat e depozitimit:** Një strukturë vend-depozitimi pranon vetëm ato mbeturina të ngurta për depozitim e të cilave ka marrë leje përkatëse.
  - (b) **Kërkesat për materialet mbuluese:** Pronari ose operatori i një njësie vend-depozitimi mbulon mbeturinat e ngurta të depozituara më të paktën 0.60 metra dhe në fund të çdo dite pune, ose më shpesh nëse është e mundur, për të kontrolluar bartësit e sëmundjeve, zjarrit, erërave, mbeturinat shpërthyes.
  - (c) **Kontrolli mbi bartësit e sëmundjeve:** Pronarët ose operatorët e njësive të vend-depozitimit parandalojnë vektorët e sëmundjeve duke përdorur teknika që janë të përshtatshme për të mbrojtur shëndetin publik dhe mjedisin. “Vektorët e sëmundjes” nënkuptojnë çdo lloj brejtësi, mizash, mushkonjash dhe insektet që mund të transmetojnë sëmundje tek njerëzit.
  - (d) **Kontrolli mbi gazet eksplozive:** Pronarët ose operatorët e njësive të vend-depozitimit sigurojnë që përqendrimi i gazit të metanit i cili prodhohet në vend-depozitim nuk e kalon kufirin prej 25 përqind të limitit të poshtëm të shpërthimit për metanin (nuk përfshihen këtu strukturat për sistemet e kontrollit dhe ripërdorimit të gazit).
  - (e) **Kriteri i ajrit:** Pronarët ose operatorët e njësive të vend-depozitimit sigurojnë që vend-depozitimi nuk shkel asnjë nga kriteret dhe normat në fuqi mbi shkarkimet në atmosferë.
  - (f) **Kërkesat e hyrjes dhe të sigurisë:** Struktura e vend-depozitimit është e siguruar në mënyrë të përshtatshme me porta, gardhe dhe me elemente të tjera sigurie. Rruga hyrëse duhet të jetë e përshtatshme në çfarëdolloj moti dhe e mbajtur në një gjendje të mirë. Në hyrje të vend-depozitimit vendosen tabela që japin informacion mbi procedurat e hedhjes së mbeturinave dhe kohën gjatë së cilës pika është e hapur për përdorim publik.

- (g) **Kërkesat për kontrollin e erozionit dhe të sedimenteve:** Për të shmangur lymën të largohet nga vend-depozitimi dhe për të penguar fenomenin e erozionit, përdoren masa të përshtatshme (struktura ose paisje) për kontrollet sedimentare.
- (h) **Kërkesat për kontrollin dhe mbrojtjen nga depërtimi i ujit:** ujërat e reshjeve devijojnë drejtimin nga zona funksionale e vend – depozitimit dhe nuk lejohen të bien mbi apo të depërtojnë në mbeturina.
- (i) **Kërkesa të shpërndarjes dhe ngjeshjes:** Njësitë e vend-depozitimit i depozitojnë mbeturinat e ngurta në sipërfaqen më të vogël të mundshme.

## **Neni 46**

### *v. Plani përmbyllës dhe post-përmbyllës*

- 109) Pronari ose operatori i njërive të vend-depozitimit përgatit planin përmbyllës, në të cilin jepen të gjitha hapat e nevojshëm për të mbyllur cilëndo nga njësitë e vend-depozitimit në çdo kohë gjatë jetës së tyre aktive në përputhje me kërkesat e sistemit të mbulesës përfundimtare.
- 110) **Plani përmbyllës përmban:**
- (i.) Përshkrimin e sistemit të mbulesës përfundimtare dhe metodat dhe procedurat që do të përdoren për ta instaluar atë.
  - (ii.) Pronari ose operatori fillojnë aktivitetet përmbyllëse jo më vonë se 30 ditë pas marrjes së fundit të mbeturinave. Shtrirjet përtej afatit për fillimin e aktivitetit përmbyllës jepen nga komisioni (Neni 35) nëse pronari ose operatori dëshmojnë se kjo njësi ka kapacitet për të depozituar më shumë mbeturina, dhe se ai merr masat e nevojshme për të mbrojtur shëndetin dhe mjedisin.
  - (iii.) Pronari ose operatori i përfundon aktivitetet përmbyllëse për sejcilën nga njësitë e vend-depozitimit brenda 180 ditësh pas fillimit të përmbylljes.
- 111) **Përmbajtja e planit post-përmbyllës:**
- Pronari ose operatori i njërive të vend-depozitimit përgatit një plan post-përmbyllës të shkruar që përfshin: një përshkrim të aktiviteteve monitoruese; emrin, adresën dhe numrin e telefonit të personit ose zyrës që mund të kontaktohet për t'u pyetur gjatë periudhës së post-mbylljes; një përshkrim të përdorimeve të planifikuara të pasurisë gjatë periudhës së post-përmbylljes; i cili nuk duhet të krijojë probleme për sistemin e mbulesës përfundimtare, për sistemin e shtresave bazale dhe për komponentë të tjerë të sistemit.

## **Neni 47**

### *vi. Plani i monitorimit të cilësisë së ujit*

- 112) Me përfundimin e ndërtimit të vend-depozitimit fillon monitorimi i ujit nëntoksor i cili bëhet gjatë të gjithë jetës aktive dhe periudhës së kujdesit post-përmbyllës të vend-depozitimit.
- 113) **(i) Sistemet monitoruese:**
- 114) Sistemi monitorues i ujit nëntoksor, përbëhet nga një numër i mjaftueshëm pusesh, të instaluar në vendet e përshtatshme dhe me thellësi të duhur, në mënyrë që të përftohen kampione nga formacioni ujëmbajtës më pranë sipërfaqes së tokës.

- 115) Numri, hapësira, dhe thellësia e sistemeve të monitorimit përcaktohet duke u bazuar në informacionin teknik të sipërfaqes, i cili përfshin shqyrtim të: trashësisë së formacionit ujëmbajtës, shpëjtësinë e rrjedhjes së ujit nëntokësor, drejtimin e rrjedhjes, prurjet stinore nëntokësore, si dhe njësitë gjeologjike të saturuara dhe jo të saturuara që shtrihen përreth formacionin ujëmbajtës.
- 116) **(ii) Programi monitories:**
- 117) Pronari ose operatori që do të ndërtojë e shfrytëzojë një vend-depozitim harton programin e monitorimit të kësaj veprimtarie. Programi i monitorimit hartohet sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 131, datë 31.03.2002 “Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë”. Programi i monitorimit miratohet nga organi që jep lejen mjedisore.
- 118) Rezultatet që dalin nga procesi i monitorimit regjistrohen në Regjistrin e Monitorimit dhe publikohen për t’u bërë të njohura për komunitetin.
- 119) Kur e gjykojnë të arsyeshme, organet e kontrollit kanë të drejtë të kërkojnë vlerësimin e saktësisë së të dhënave që kanë dalë nga monitorimi.
- 120) Shpenzimet për monitorimin përballohen nga pronari ose operatori i vend-depozitimit.
- 121) Sistemi monitorues përfshin procedura të marrjes së kampioneve dhe të analizave për të siguruar rezultate të sakta të cilësisë së ujit nëntokësor. Plani i monitorimit përfshin procedura të cilat lidhen me teknikat për: mbledhje kampionesh; ruajtjen dhe transportimin e kampioneve, procedura analitike, dhe kontrollin e cilësisë.
- 122) Nëse pronari ose operatori vëren se ka rritje të konsiderueshme statistikore për një ose më shumë përbërës të përshkruar në Nenin 50 të këtij Kreu në ndonjë pus monitorues, ai duhet të: raportojë në bashki brenda 14 ditëve për këtë situatë, dhe ta shënojë këtë gjë në regjistrin e tij.
- 123) Pronari ose operatori përcakton edhe shkaqet e këtij ndryshimi
- 124) Pas 90 ditësh nga konstatimi pronari ose operatori fillon vlerësimet për marrjen e masave ndreqëse. Një vlerësim i tillë përfundohet brenda një periudhe të arsyeshme kohe.
- 125) Duke u bazuar në rezultatet e vlerësimit, pronari ose operatori zgjedh një mënyrë për ndreqjen e situatës, që të paktën: nuk shkakton probleme për jetën e njerëzve dhe për mjedisin; përputhet me standartet e mbrojtjes së burimeve nën ujore.

## Neni 48

### 4. Kufizimet për vendndodhjen e vend-depozitimit

- 126) Njësiti e vend-depozitimit plotësojnë kriteret e vendosura në këtë nen. Për të vërtetuar pajtueshmërinë me kriteret të veçanta, mund të kërkohet dhe dokumentacion ose miratim nga institucione të tjera përveç komisionit.
- 127) **Siguria aeroportuale:** Një njësi e re vend-depozitimit duhet të vendoset jo më afër sesa 2 000 metra larg nga çdo lloj aeroporti.
- 128) **Zonat e përmbytjes:** Njësiti e vend-depozitimit nuk vendosen në zona që janë përmbytur gjatë 100-vjeçarit të fundit.
- 129) **Ligatinat:** Njësiti e vend-depozitimit nuk shtrihen në ligatina, me përjashtim të rasteve kur pronari ose operatori i dëshmojnë komisionit se ndërtimi dhe puna në këto vend-depozitime: nuk shkakton shkeljen e ndonjë standarti të cilësisë së ujit; nuk shkel asnjë standart të shkarkimit të mbeturinave ujore; nuk prek speciet e rrezikuara, ose habitatet kritike; vend-depozitimi nuk kontribon në degradimin e ligatinave. Pronari ose operatori dëshmojnë gjithashtu integritetin e vend-depozitimit, dhe mundësinë për të mbrojtur burimet ekologjike, duke shqyrtuar faktorët e mëposhtëm:
- Erozionin, stabilitetin, dhe potencialin e ligatinave, baltrave dhe depozitave për të mbrojtur njësiti e vend-depozitimit
  - Ndikimin tek peshqit, jeta e egër, dhe të habitatet e tyre si rezultat i ndotjes nga mbeturinat urbane;
  - Efektet e mundshme nga derdhja në rast katastrofe të mbeturinave tek ligatinat, dhe efektet e tyre mbi mjedisin, dhe;
  - Çdo faktor tjetër plotësues, për të treguar se burimet ekologjike në ligatina janë mjaftueshmërisht të mbrojtura.
- 130) **Zonat e shkara:** Njësiti e vend-depozitimit nuk vendosen në sipërfaqen brenda 60 metrave të një shkarjeje e cila ka ndodhur kohë më parë.
- 131) **Zonat sizmike:** Njësiti e vend-depozitimit nuk vendosen në zona me ndikim sizmik, përveç rasteve kur pronari ose operatori i provojnë komisionit se të gjitha strukturat përkatëse, duke përfshirë sistemet e shtresave, sistemet e grumbullimit të rrjedhjes, sistemet e grumbullimit të ujërave nga reshjet atmosferike, janë hartuar për t'i rezistuar maksimumit të shpejtësisë horizontale të kores së tokës në zonën përkatëse.
- 132) **Zona të paqendrueshme:** Pronarët ose operatorët e vend-depozitimit dhe zgjerimeve anësore të vendosura në një zonë jo të qendrueshme duhet të provojnë se masat inxhinierike sigurojnë se integriteti i komponentëve strukturorë të vend-depozitimi nuk do të preket. Zonat e paqendrueshme mund të përfshijnë zona karstike, zona që dyshohen si të pazozueshme në rastet e lëvizjeve masive.
- 133) **Vlerat kulturore:** Një vend-depozitim nuk duhet të dëmtojë një pasuri arkeologjike ose historike. Komisioni i referofet Institutit të Monumenteve të Kulturës për të përcaktuar vlerat arkeologjike ose historike.
- 134) **Ruajta e natyrës:** Një vend-depozitim dhe të gjitha zgjerimet e tij të mundshme nuk duhet të kenë asnjë efekt të pakthyeshëm ose influencë negative mbi zonat me status “zonë e mbrojtur”.



- 135) **Zona ujëmbledhëse e një rezervuari:** Një vend-depozitim ose çdo zgjerim tjetër i tij nuk duhet të shtrihen në zonën ujëmbledhëse të rezervuarit ose të një segmenti të një përroi.
- 136) **Speciet e rrezikuara:** Një vend – depozitim nuk duhet të shqetësojë speciet e rrezikuara dhe që po shkojnë drejt zhdukjes, dhe nuk duhet të kontribuojnë në shkatërrimin e habitateve kritike.

## Neni 49

### 5. Kërkesat për ndërtimin e vend-depozitimit

- 137) Ndërtimi i vend-depozitimit bazohet në përshkrimet dhe kriteret e mëposhteme:
- 138) **Dizenjimi dhe ndërtimi i sistemit të shtresave bazale:** Ky sistem vendoset në tabanin e vend-depozitimit, dhe dizenjohet për të mbledhur dhe për të hequr elementet e rrjedhjes nga vend-depozitimi. Ai përmban:
- (i.) *Një shtresë bazale:* përbëhet nga argjilë e ngjeshur me përshkueshmëri jo më shumë se  $1 \times 10^{-7}$  cm<sup>3</sup>/sek dhe një minimum trashësie prej 0.61 metra dhe ose një shresë kompozite e përbërë nga shtresa gjeosintetike dhe gjeomembranore.
  - (ii.) *Një sistem grumbullimi të rrjedhjes:* sistem i ndërtuar drejtpërdrejt mbi shtresën bazale dhe hartohet për të mbledhur dhe hequr rrjedhjen nga vend-depozitimi.
- 139) **Dizenjimi, ndërtimi dhe funksionimi i një sistemi të grumbullimit të rrjedhjes:** Ky sistem mbledhës, nga pikëpamja hidraulike, tërheq rrjedhjen nga vend-depozitimi, i rezonon bllokimit dhe mundëson mbledhjen e rrjedhjes dhe heqjen e saj nga vend-depozitimi.
- 140) **Kërkesat për pozicionin horizontal:** Në zonën ku ndërtohet njësi e re e vend-depozitimit planifikohet të paktën 90 metra zonë neutrale midis njësisë së vend-depozitimit dhe kufirit të pronës; 500 metra larg ndërtesave që përdoren si banesa të përhershme nga njerezit; 100 metra larg çdo shtëpie të vetmuar; 500 metra larg autostradave dhe rrugëve nacionale; 1000 metra larg shtratit të lumenjve dhe brigjeve të liqeneve; 2000 metra larg nga pus çpimet e vendosura në zonat ujëmbajtëse të përdorura për nxjerrjen e ujit të pijshëm; 60 metra larg nga tubacionet e gazit; 30 metra larg nga hekurudhat.
- 141) **Kërkesa për pozicionin vertikal:** Një vend-depozitim ndërtohet në mënyrë të tillë që pjesa e poshtme e shtresës bazale të jetë të paktën 1.5 metra mbi nivelin më të lartë sezonal të ujit nëntokësor.
- 142) **Nivelimi i vend-depozitimit:** Nivelimi i vend depozitimit bëhet i njëjtë me nivelin fillestar të sipërfaqes; ndërtohet muratura, zgjidhet materiali me të cilin do të mbushet trualli në të cilin do të ndërtohet njësi. Pjerrësia minimale për nivelin duhet të jetë 2 përqind.
- 143) **Shtresat prej argjile të ngjeshur:** Për të parandaluar depërtimin e ujit përdoren shtresat prej argjile të ngjeshur, të cilat janë pengesa me përshkueshmëri të ulët të hartuar.
- 144) **Shtresat argjilore gjeosintetike:** Shërbejnë si pengesa hidraulike gjeosintetike të prodhuara në fletë dhe të instaluar me teknikën e qepjes në fushë.

- 145) **Tuba për mbledhjen e rrjedhjes:** Rrjeti i tubave mbledhës të rrjedhjes duhet të jetë i dizenuar nga pikëpamja hidraulike për të tërhequr rrjedhjen nga vend-depozitimi dhe për ta dërguar atë në depozitë për t'u grumbulluar ose trajtuar më tej.
- 146) **Shtresat e kullimit:** Çdo rrjet granular, ose gjeosintetik materialesh nuk influencohet nga vendosja e mbeturinave ose rrjedhja e prodhuar nga vend-depozitimi.
- 147) **Kriteret e vendosjes së filtrës:** Të gjitha shtresat e filtrës të përdorura në sistemin e mbledhjes së rrjedhjeve hartohen për të penguar migrimin e pjesëve të imta të dheut dhe për të lejuar ujin ose gazrat të hyjnë lirshëm në sipërfaqen e tubave.
- 148) **Kontrolli i sedimentimit dhe i erozionit:** Struktura dhe masa të përshtatshme duhet të hartohen për të mirëmbajtur dhe për të menaxhuar sasinë e ujërave nga rreshjet atmosferike maksimale gjatë 24 orëve të ndodhur me stuhi më të fuqishme të 25-vjeçarit të fundit.

## Neni 50

**Tabela 1**

### Përqendrimit maksimale të lejuara në ujera nëntokësore

Elementet Kimike	Limiti Maksimal i Përqendrimit (mg/l)
Arseniku	0.05
Bariumi	1.0
Benzina	0.005
Kadminium	0.01
Tetraklidi i Karbonit	0.005
Kromi	0.5
Acid Acetik diploopeniks	0.1
Diklorobenzine 1,4	0.075
Diklorothiline 1,2	0.005
Diklorotiline 1,1	0.007
Endrin	4
Florine	4
Lindane	0.004
Plumb	0.05
Merkur	0.002
Klor Metani	0.1
Nitrati	10.0
Selenium	0.01
Argjend	0.05
Toxaphene	0.005
Acid Actik Triklorofeniks	0.01
Klorid Vinil	0.002

## Neni 51

### 6. Kërkesat për ruajtjen e elementeve që dalin nga rrjedhja

- 149) Procesi i punës dhe mbylljes së të gjithë depove të ruajtjes së elementeve të rrjedhjes dhe grumbullimi i ujit në rezervuar duhet të përfshijë këto elementë:

- Një përshkrim të lëngut që duhet ruajtur
- Volumin e lëngut të prodhuar dhe regjistrimin e masës së tij
- Një skedulë për lëvizjen e lëngut
- Një përshkrim të trajtimit përfundimtar dhe të depozitimit të lëngut të ruajtur
- Një përshkrim të njësisë së ruajtjes së lëngut
- Një plan kontigjent për menaxhimin e rritjes së masës së lëngut, dhe
- Një plan përmbledhës.

150) Depozitat vendosen mbi tokë, ose nën tokë, të ndërtuara nga plastika speciale, prej hekuri apo betoni. Të gjitha llojet e depozitave duhet të jenë të pajisura me sisteme që pengojnë derdhjen e lëngut.

## KREU VI

### KOMPOSTIMI I MBETURINAVE URBANE ORGANIKE

---

#### Neni 52

##### 1. Kushte për kompostimin

- 151) Kushtet e përcaktuara në këtë kre aplikohen në strukturat e kompostimit të Mbeturinave Urbane të Riciklueshme apo të kompostimit të këtyre mbeturinave të përziera me mbeturina të jashtëqitjeve. Këto të fundit nuk klasifikohen si mbeturina të ngurta të riciklueshme por në strukturat e kompostimit luajnë rolin e pasuruesit me azot.
- 152) Strukturat kompostuese të mbejteve të ngurta të riciklueshme klasifikohen në bazë të llojit dhe sasisë së materialit që kompostohet.
- 153) Strukturat kompostuese pranojnë për kompostim Mbeturinat Urbane të Lulishteve, mbeturinat e silvikulturës, mbeturina drusore të papërpunuara dhe të palyera me bojra, apo çfarëdo kombinimi të llojeve të mbeturinave të përcaktuara më lart. Strukturat kompostuese mund të pranojnë për kompostim mbeturina të bizneseve të vogla që merren me përpunim e produkteve ushqimore, mbeturina bujqësore, letër të riciklueshme. Mbeturinat e mësipërme janë me përqendrim të ulëta patogjenësh dhe substancave kontaminuese.
- 154) Strukturat të Vogla Kompostuese janë ato që pranojnë, përpunojnë dhe grumbullojnë më pak se 5,000 metra kub mbeturina për çdo tre-mujor.
- 155) Strukturat e Mëdha Kompostuese janë ato që pranojnë, përpunojnë dhe grumbullojnë më shumë se 5,000 metra kub mbeturina për çdo tre-mujor.
- 156) Nuk është e nevojshme marrje e lejes për operimin e: strukturave të vogla kompostuese, strukturat kompostuese në kopështet private dhe strukturat kompostuese të fermave tek të cilat materiali i kompostuar nxirret nga vegetacioni që rritet në tokën e vetë pronarit dhe komposti përfundimtar përdoret në vetë tokën e pronarit dhe nuk i shitet publikut.
- 157) Leja për operimin e strukturës kompostuese është e nevojshme për operimin e një Strukture të Madhe Kompostuese. Struktura e Madhe Kompostuese operon në bazë të dokumentacionit të dorëzuar nga pronari / operatori gjatë procesit të marrjes së lejes për të ngritur një Strukturë Kompostuese të Madhe.
- 158) Leja për të ndërtuar dhe vënë në punë një Strukturë të Madhe Kompostuese jepet nga një komision i cili përbëhet nga përfaqësues të:
- Qeverisë vendore
  - Inspektoratit sanitar shtetëror të rrethit
  - Inspektoratit të mbtojtjes së mjedisit
  - Ndërmarrjes pastruese të zonës së banuar
  - Urbanistikës së bashkisë

## Neni 53

### 2. Kufizime për strukturat e kompostimit

- 159) Është e ndaluar pranimi dhe përpunimi i Mbeturinave të Rrezikshme në strukturën e kompostimit.
- 160) Depozitohet në vend–depozitim çfarëdolloj komposti i cili gjatë procesit të kompostimit është përzier me mbeturina të ngurta të cilat nuk përputhen me kushtet për kompostimin e mbeturinave urbane të riciklueshme.

## Neni 54

### 3. Kërkesat operacionale për strukturat e kompostimit

- 161) Personat që operojnë një Strukturë të Madhe Kompostuese e menaxhojnë atë në përputhje me kërkesat e lejes që kanë marrë.
- 162) Për kontrollon e erozionit merren masa që të parandalohet erozioni në zonën e vendosjes së strukturës kompostuese dhe të kontrollohen lëvizjet e dherave të kontaminuara.
- Ujërat sipërfaqësore devijohen nga zonat ku punon stafi, nga zona ku kryhet kompostimi dhe nga zona ku pranohen dhe grumbullohen mbeturinat.
  - Rjedhja grumbulohet brenda zonës së strukturës kompostuese dhe trajtohet për të qenë brenda standarteve dhe normave në fuqi përpara se të bashkohet me ujërat e zeza.
- 163) Kërkesat për shfrytëzimin dhe sigurinë e strukturës së kompostimit:
- Strukturat e Mëdha të Kompostimit sigurohen me anë të portave, gardheve apo me masa të tjera sigurie që ndalojnë hyrjet e paautorizuara.
  - Të paktën një punonjës është gjithmonë i pranishëm në strukturën kompostuese gjatë kohës që kjo strukturë është e hapur për publikun në mënyrë që të sigurohet ndjekja e procedurave dhe të kontrollohet hyrja në strukturën e kompostimit.
  - Rruga për tek struktura e kompostimit është e mirëmbajtur që të shfrytëzohet në çfarëdo lloj kohe.
  - Struktura e kompostimit pranon vetëm ato mbeturina që i lejohet të përpunojë.
  - Ndalohet djegja e mbeturinave në strukturën e kompostimit.
  - Personeli informohet për masat specifike të sigurisë që merren në strukturën e kompostimit.
- 164) Në hyrje të strukturës së kompostimit afishohet informacion mbi llojin e mbeturinave që pranohen në strukturën e kompostimit, procedurat e dorëzimit të mbeturinave, orarin gjatë të cilit struktura e kompostimit është e hapur për publikun, si dhe informacione të tjera që gjykohen të nevojshme nga operatori.
- 165) Kërkesat e monitorimit:
- Në lejen e operimit të strukturës kompostuese përfshihen specifikimet e bëra për monitorimin dhe raportimin.

- Temperatura e kompostit monitorohet në mënyrë të tillë që të sigurojë zbatimin e kriterëve për mënjanimin e patogjenëve.
- 166) Procesi i kompostimit kryhet në temperaturën 55 gradë Celcius apo më shumë për një kohëzgjatje 3 ditore. Gjatë kësaj periudhe sigurohet që masa e kompostit të ketë kontakt të mjaftueshëm me ajrin për të arritur temperaturën e kërkuar.

## **Neni 55**

### **4. Plani i monitorimit të cilësisë së ujit**

- 167) Njësitë e strukturës së kompostimit ndërtohen mbi bazën e kriterëve të përcaktuara përpara se aty të depozitohen mbeturinat në strukturën e kompostimit. Me përfundimin e strukturës së kompostimit fillon monitorimi i ujit nëntokësor i cili bëhet gjatë të gjithë jetës aktive dhe periudhës së kujdesit post-përmbyllës të strukturës së kompostimit.
- 168) **(i) Sistemet monitoruese:**
- 169) Sistemi monitorues i ujit nëntokësor, përbëhet nga një numër i mjaftueshëm pusesh, të instaluar në vendet e përshtatshme dhe me thellësi të duhur, në mënyrë që të përftohen kampione nga formacioni ujëmbajtës më pranë sipërfaqes së tokës.
- 170) Numri, hapësira, dhe thellësia e sistemeve të monitorimit përcaktohet duke u bazuar në informacionin teknik të sipërfaqes, i cili përfshin shqyrtim të: trashësisë së formacionit ujëmbajtës, shpejtësinë e rrjedhjes së ujit nën tokësor, drejtimin e rrjedhjes, prurjet stinore nëntokësore, si dhe njësitë gjeologjike të saturuara dhe jo të saturuara që shtrihen përreth formacionin ujëmbajtës.
- 171) **(ii) Programi monitorues:**
- 172) Pronari ose operatori që do të ndërtojë e shfrytëzojë një strukturë kompostimi harton programin e monitorimit të kësaj veprimtarie. Programi i monitorimit hartohet sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 131, datë 31.03.2002 “Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë”. Programi i monitorimit miratohet nga organi që jep lejen mjedisore.
- 173) Rezultatet që dalin nga procesi i monitorimit regjistrohen në Regjistrin e Monitorimit dhe publikohen për t’u bërë të njohura për komunitetin.
- 174) Kur e gjykojnë të arsyeshme, organet e kontrollit kanë të drejtë të kërkojnë vlerësimin e saktësisë së të dhënave që kanë dalë nga monitorimi.
- 175) Shpenzimet për monitorimin përballohen nga pronari ose operatori i strukturës së kompostimit.
- 176) Sistemi monitorues përfshin procedura të marrjes së kampioneve dhe të analizave për të siguruar rezultate të sakta të cilësisë së ujit nëntokësor. Plani i monitorimit përfshin procedura të cilat lidhen me teknikat për: mbledhje kampionesh; ruajtjen dhe transportimin e kampioneve, procedura analitike, dhe kontrollin e cilësisë.
- 177) Nëse pronari ose operatori vëren se ka rritje të konsiderueshme statistikore për një ose më shumë përbërës të përshkruar në Nenin 50 në ndonjë pus monitorues, ai duhet të: raportojë në bashki brenda 14 ditëve për këtë situatë, dhe ta shënojë këtë gjë në regjistrin e tij.
- 178) Pronari ose operatori përcakton edhe shkaqet e këtij ndryshimi

- 179) Pas 90 ditësh nga konstatimi pronari ose operatori fillon vlerësimet për marrjen e masave ndreqëse. Një vlerësim i tillë përfundohet brenda një periudhe të arsyeshme kohe.
- 180) Duke u bazuar në rezultatet e vlerësimit, pronari ose operatori zgjedh një mënyrë për ndreqjen e situatës, që të paktën: nuk shkakton probleme për jetën e njerëzve dhe për mjedisin; përputhet me standartet e mbrojtjes së burimeve nën ujore.

## Neni 56

### 5. Shpërndarja e produkteve të kompostit

- 181) Komposti nuk përdoret si pleh për tokën dhe nuk i jepet një pale tjetër për përdorim si pleh në qoftë se përqendrimi i njërës prej metaleve është më i lartë sesa përqendrimet e paraqitura në tabelën e mëposhtme.
- 182) Përqendrimi i Metalit në mg për kg nuk duhet t'i kalojë:

Arsenik	Kadmium	Bakër	Plumb	Zhivë	Nikel	Selenium	Zink
41	39	1500	300	17	420	36	2800

- 183) Inertet e përfshira në kompost nuk kanë përmasa më të mëdha se 1.5 cm.
- 184) Nga komposti i prodhuar në Strukturat e Mëdha Kompostuese analizohen kampione si vijon:
- 185) Një kampion përfaqësues i kompostit të prodhuar do të analizohet për çdo gjashtë muaj, për parametrat e përshkruara në tabelën e mëposhtme:

Parametri	Njësia
Materiale të huaja	%
Kadmium	mg/kg të peshës së tl
Bakër	mg/kg të peshës së tl
Plumb	mg/kg të peshës së tl
Nikel	mg/kg të peshës së tl
Zink	mg/kg të peshës së tl
Patogjenë	
Total Azot	%

- 186) Metodologjia e analizave për çdo parametër përcaktohet nga Instituti i Higjenës.

## Neni 57

### 6. Kufizimet e vend-ndodhjes për strukturat e kompostimit

- 187) Njësitë e strukturës së kompostimit plotësojnë kriteret e vendosura në këtë nen. Për të vërtetuar pajtueshmërinë me kritere të veçanta, mund të kërkohet dhe dokumentacion ose miratim nga institucione të tjera përveç komisionit.
- 188) **Zonat e përmbytjes:** Njësitë e strukturës së kompostimit nuk vendosen në zona që janë përmbytur gjatë 100-vjeçarit të fundit.

- 189) **Ligatinat.** Njësitë strukturës së kompostimit nuk shtrihen në ligatina, me përjashtim të rasteve kur pronari ose operatori i dëshmojnë komisionit se ndërtimi dhe puna në këto struktura kompostimi: nuk shkakton shkeljen e ndonjë standarti të cilësisë së ujit; nuk shkel asnjë standart të shkarkimit të mbeturinave ujore; nuk prek speciet e rrezikuara, ose habitatet kritike; struktura e kompostimit nuk kontribuon në degradimin e ligatinave.
- 190) **Zonat e shkara:** Njësitë e strukturës së kompostimit nuk vendosen në sipërfaqen brenda 60 metrave të një shkarjeje e cila ka ndodhur kohë më parë.
- 191) **Zonat sizmike:** Njësitë e strukturës së kompostimit nuk vendosen në zona me ndikim sizmik, përveç rasteve kur pronari ose operatori i provojnë komisionit së të gjitha strukturat përkatëse, duke përfshirë sistemet e shtresave, sistemet e grumbullimit të rrjedhjes, sistemet e grumbullimit të ujërave nga reshjet atmosferike, janë hartuar për t'i rezistuar maksimumit të shpejtësisë horizontale të kores së tokës në zonën përkatëse.
- 192) **Zona të paqendrueshme:** Pronarët ose operatorët e strukturës së kompostimit të vendosura në një zonë të paqendrueshme duhet të provojnë se masat inxhinierike sigurojnë se integriteti i komponentëve strukturorë të strukturës së kompostimit nuk do të preket.
- 193) **Vlerat kulturore:** Një strukturë kompostimi nuk dëmton një pasuri arkeologjike ose historike. Komisioni i referohet Institutit të Monumenteve të Kulturës për të përcaktuar vlerat arkeologjike ose historike.
- 194) **Ruajta e natyrës:** Një strukturë kompostimi nuk duhet të ketë asnjë efekt të pakthyeshëm ose influencë negative mbi zonat me status “zonë e mbrojtur”.
- 195) **Zona ujëmbledhëse e një rezervuari:** Një strukturë kompostimi ose çdo zgjerim tjetër i tij nuk duhet të shtrihen në zonën ujëmbledhëse të rezervuarit ose të një segmenti të një përroi.
- 196) **Speciet e rrezikuara:** Një strukturë kompostimi nuk duhet të shqetësojnë speciet e rrezikuara dhe që po shkojnë drejt zhdukjes, dhe nuk duhet të kontribuojnë në shkatërrimin e habitateve kritike.

## Neni 58

### 7. Kërkesat për ndërtimin e strukturës së kompostimit

- 197) Ndërtimi i strukturës së kompostimit bazohet në përshkrimet dhe kriteret e mëposhtëme:
- 198) **Dizenjimi dhe ndërtimi i sistemit të shtresave bazale:** Ky sistem vendoset në tabanin e strukturës së kompostimit, dhe dizenjohet për të mbledhur dhe për të hequr elementet e rrjedhjes nga struktura e kompostimit. Ai përmban:
- (iii.) *Një shtresë bazale:* përbëhet nga argjilë e ngjeshur me përshkueshmëri jo më shumë se  $1 \times 10^{-7}$  cm<sup>3</sup>/sek dhe një minimum trashësie prej 0.61 metra dhe ose një shtresë kompozite e përbërë nga shtresa gjeosintetike dhe gjeomembranore.
  - (iv.) *Një sistem grumbullimi të rrjedhjes:* sistem i ndërtuar drejtpërdrejt mbi shtresën bazale dhe hartohet për të mbledhur dhe hequr rrjedhjen nga struktura e kompostimit.
- 199) **Hartimi dhe funksionimi i një sistemi të grumbullimit të rrjedhjes:** Ky sistem mbledhës, nga pikëpamja hidraulike, tërheq rrjedhjen nga struktura e kompostimit, i



rezison bllokimit dhe mundëson mbledhjen e rrjedhjes dhe heqjen e saj nga struktura e kompostimit.

- 200) **Kërkesat për pozicionin horizontal:** Njësitë e reja të strukturës së kompostimit planifikojnë të paktën 90 metra zonë neutrale midis njësisë së strukturës së kompostimit dhe kufirit të pronës; 500 metra larg ndërtesave që përdoren si banesa të përhershme nga njerëzit; 100 metra larg çdo shtëpie të vetmuar; 500 metra larg autostradave dhe rrugëve nacionale; 1000 metra larg shtratit të lumenjve dhe brigjeve të liqeneve; 2000 metra larg nga pus çpimet e vendosura në zonat ujëmbajtëse të përdorura për nxjerrjen e ujit të pijshëm; 60 metra larg nga tubacionet e gazit; 30 metra larg nga hekurudhat.
- 201) **Kërkesa për pozicionin vertikal:** Një strukturë kompostimit ndërtohet në mënyrë të tillë që pjesa e poshtme e shtresës bazale të jetë të paktën 1.5 metra mbi nivelin më të lartë sezonal të ujit nëntokësor.
- 202) **Nivelimi i strukturës së kompostimit:** Nivelimi i strukturës së kompostimit bëhet i njëjtë me nivelin fillestar të sipërfaqes; ndërtohet muratura, zgjidhet materiali më të cilën do të mbushet trualli në të cilin do të ndërtohet njësia. Pjerrësia minimale për nivelin duhet të jetë 2 përqind.
- 203) **Shtresat prej argjile të ngjeshur:** Janë pengesa me përshkueshmëri të ulet të hartuar për të parandaluar depërtimin e ujit.
- 204) **Shtresat argjilore gjeosintetike:** Shërbejnë si pengesa hidraulike gjeosintetike të prodhuara në fletë dhe të instaluar me teknikën e qepjes në fushë.
- 205) **Tuba për mbledhjen e rrjedhjes:** Rrjeti i tubave mbledhës të rrjedhjes duhet të jetë i dizenuar nga pikëpamja hidraulike për të tërhequr rrjedhjen nga struktura e kompostimit dhe për ta dërguar atë në depozitë për t'u grumbulluar ose trajtuar më tej.
- 206) **Shtresat e kullimit:** Çdo rrjet granular, ose gjeosintetik materialesh nuk influencohet nga vendosja e mbeturinave ose rrjedhja e prodhuar nga struktura e kompostimit.
- 207) **Kriteret e vendosjes së filtrës:** Të gjitha shtresat e filtrës të përdorura në sistemin e mbledhjes do të hartohen për të penguar migrimin e pjesëve të imta të dheut dhe për të lejuar ujin ose gazrat të hyjnë lirshëm në sipërfaqen e tubave.
- 208) **Kontrolli i sedimentimit dhe i erozionit:** Struktura dhe masa të përshtatshme duhet të hartohen për të mirëmbajtur dhe për të menaxhuar sasinë e ujërave nga rreshjet atmosferike maksimale gjatë 24 orëve të ndodhur me stuhi më të fuqishme të 25-vjeçait të fundit.

## Neni 59

### 8. Kërkesat për ruajtjen e elementeve që dalin nga kullimi

- 209) Procesi i punës dhe mbylljes së të gjithë depove të ruajtjes së elementeve të rrjedhjes dhe grumbullimi i ujit në rezervuar duhet të përfshijë këto elemente:
- Një përshkrim të lëngut që duhet ruajtur
  - Volumin e lëngut të prodhuar dhe regjistrimin e masës së tij
  - Një skedulë për lëvizjen e lëngut
  - Një përshkrim të trajtimit përfundimtar dhe të depozitimit të lëngut të ruajtur
  - Një përshkrim të njësisë së ruajtjes së lëngut
  - Një plan kontigjent për menaxhimin e rritjes së masës së lëngut, dhe

- Një plan përmbledhës.
- 210) Depozitat vendosen mbi tokë, ose nën tokë, të ndërtuara nga plastika speciale, prej hekuri apo betoni. Të gjitha llojet e depozitave duhet të jenë të pajisura me sisteme që pengojnë derdhjen e lëngut.

## **KREU VII**

### **TARIFAT**

---

#### **Neni 60**

##### **1. Vjelja e tarifës**

- 211) Tarifa e pastrimit vilet nga autoritetet e bashkisë për mbulimin e shpenzimeve të heqjes së mbeturinave dhe pastrimin e qytetit
- 212) Autoritetet e bashkisë mund të ngarkojnë një palë të tretë me përlogaritjen e këtyre tarifave, hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për këto tarifa, marrjen dhe transferimin e tyre, lëshimin e vërtetimeve për autoritetet e bashkisë, përpunimin e të dhënave të kërkuara dhe vënien në dijeni të autoriteteve.

#### **Neni 61**

##### **2. Objekti i tarifës**

- 213) Tarifat vilen për pastrimin e qytetit, për vënie në gjendje pune dhe përdorimin e impianteve për largimin, transportin, depozitimin dhe përpunimin e mbeturinave

#### **Neni 62**

##### **3. Taksapaguesit**

- 214) Niveli i tarifës përcaktohet me një vendim të veçantë të Këshillit Bashkiak.
- 215) Vendosja e tarifës së pastrimit, pagesa dhe vjelja e saj kryhen sipas vendimit të Këshillit Bashkiak për tarifën e pastrimit.

## **KREU VIII**

### **SANKSIONET**

---

#### **Neni 63**

##### **Sanksionet**

- 216) Ndaj personave fizikë dhe juridikë që nuk respektojnë kërkesat e kësaj rregulloreje, zbatohen sanksionet e ligjit Nr.8094, datë 21.3.1996, 'Për largimin publik të mbeturinave',
- 217) Mosrespektimi i kësaj rregulloreje dënohet sipas URDHËRESËS PUBLIKE Nr. \_\_\_\_\_  
Datë \_\_\_\_\_.

## KREU IX

### MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

---

#### Neni 64

##### 1. Detyrimi për informim

- 218) Bashkia bën publike skemën e pastrimit, oraret e pastrimit dhe oraret e preferueshme për dorëzimin dhe largimin publik të mbeturinave.
- 219) Në procesin e vendimmarrjes për caktimin e vend-depozitimeve e për njësi kompostimi dhe për shfrytëzimin e tyre, ftohen të marrin pjesë OJF-të mjedisore dhe publiku i interesuar.
- 220) Kushdo ka të drejtë të kërkojë të informohet për ecurinë e procesit të largimit publik të mbeturinave sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara për këtë çështje.
- 221) Personat fizikë e juridikë që janë angazhuar në largimin publik të mbeturinave, që kanë dhe përdorin vend-depozitime apo njësi të kompostimit, publikojnë të dhënat që u rezultojnë nga monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarive të tyre, jo më rrallë se një herë në tre muaj.

#### Neni 65

##### 2. Procedurat e ankimimit dhe ekzekutimi

###### *A. Marrja e Ankesës dhe Shqyrtimi*

- 222) Çdo konsumator ka të drejtën e ankimimit me gojë ose me shkrim mbi procesin e largimit publik të mbeturinave.
- 223) Fillimisht të gjithë ankesat e klientëve depozitohen tek zyra e informacionit në bashki dhe adresohen për tek drejtuesi i seksionit të shërbimeve publike.
- 224) Pala që kryen shërbimin merr çdo ditë nga seksioni i shërbimeve listën e ankesave, e cila përmban llojin dhe burimin e ankesës.
- 225) Ajo detyrohet të ndreqë shkakun e ankesës brenda 24 orësh. Në rast mosndreqje ajo detyrohet të japë shpjegime pranë drejtuesit të seksionit të shërbimeve brenda ketij afati, lidhur me arsyet e mosndreqjes së shkakut të ankesës.

###### *B. Zgjidhja e Ankesës*

- 226) Mosndreqja e shkaqeve të ankesës, kur ato merren parasysh si të drejta konsiderohet shkelje kontrate.
- 227) Bashkia ka të drejtën të dërgojë një supervizor për të kontrolluar zgjidhjen e ankesës. Në qoftë se supervizori vëren mangësi, ai duhet të njoftojë palën që kryen shërbimin për këto mangësi. Pala duhet të njoftojë Bashkinë kur këto mangësi janë plotësuar. Pala duhet të rikontrrollojë punën për të parë nëse gjithçka është plotësuar në mënyrë të kënaqshme.

- 228) Në qoftë se supervizori vëren që mangësitë e njoftuara më parë nuk janë korigjuar, atëherë shpenzimet për kohën e supervizorit simbas kostos reale të kësaj kohe, plus kostot e tjera do t'i zbriten palës që kryen shërbimin për çdo inspektim, derisa të gjithë mangësitë e njoftuara të jenë korigjuar.

## **Neni 66**

### **3. Zbatimi i rregullores**

- 229) Zbatimit të kësaj rregulloreje i nënshtrohen:
- Organet shtetërore dhe organizatat vendore
  - Gjithë individët, banorë të qytetit e të zonës, kalimtarë të rastësishëm, turistë e pushues, shtetas të huaj rezident në qytet, punonjës në organe e organizma publike e private.
  - Gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike, tregëtare, shoqërore, arsimore, kulturore, artistike, shëndetësore, turistike.
  - Personat juridikë e fizikë, publikë dhe privatë, vendas apo të huaj, të angazhuar me kontratë dhe të liçensuar për grumbullimin, depozitimin, transportimin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin e mbeturinave.

## **Neni 67**

### **Hyrja në fuqi**

- 230) Kjo rregullore hyn në fuqi një muaj pas shpalljes dhe publikimit lokal të saj.

**PËR KËSHILLIN BASHKIAK TË BASHKISË \_\_\_\_\_**

**K R Y E T A R I**

(.....)